DREJTORIA KOMUNALE E ARSIMIT
MUNICIPALITY EDUCATION DIRECTORATE
OPSTINSKA UPRAVA PROSFETE
Nr. 610 Data. 17.8.2020
VUSHTRRI

# REPUBLIKA E KOSOVËS
## KOMUNA E VUSHTRRISË

10Nr. 610 /20
Datë: 17.08.2020

Në bazë të Ligjit për Arsimin Parauniversitar të Republikës së Kosovës Nr.04/L-032 si, në bazë të Udhëzimit Administrativ Nr. 22/2013 për Numrin maksimal të nxënësve për klasë dhe raporti mësimdhënës nxënës, në vendimin Nr.01B-69 të datës 06.08.2020 si dhe në pajtim me udhëzimet dhe/ose procedurat dhe standardet e përgjithshme të shpallura nga MASH.

DREJTORIA KOMUNALE E ARSIMIT (DKA) SHPALL

**KONKURS**

PËR REGJISTRIMIN E NXËNËSVE NË KLASËN E DHJETË (10) TË GJIMNAZIT DHE TË SHKOLLAVE PROFESIONALE PËR VITIN SHKOLLOR 2020/2021

| SHKOLLA | Drejtimi | Nr. i Paraleleve | Nr. Nxënësve në një paralele | Gjithsej për drejtim |
|---|---|---|---|---|
| Gjimnazi "Eqrem Çabej" Vushtrri | Natyror | 6 | 24 | 144 |
| | Shoqëroro – Gjuhësor | 6 | 24 | 144 |
| Gjithsej: | | 12 | | 288 |

Planifikimi për regjistrim të nxënësve në klasën e dhjetë (X ) për shkolla profesionale-Vushtrri

SHMP "Bahri Haxha" Vushtrri

| Drejtimi/Lëmia | Profili | Nr. i paraleleve | Numri i nxënësve |
|---|---|---|---|
| **Bujqësi** | Agrobiznes | **2** | **48** |
| | Hortikulturë | **1** | **24** |
| | Mbrojtja e bimëve | **1** | **24** |
| **Ndërtimtari** | Arkitekture | **1** | **24** |
| | Ndertimtar | **1** | **24** |
| **Ekonomi** | Kontabilitet dhe tatime | **1** | **24** |
| | Shpedicion dhe logjistikë | **1** | **24** |
| | Tregtarë me pakicë dhe shumicë | **1** | **24** |
| **Kimi - teknologji** | Teknologji e riciklimit | **1** | **24** |
| | Laborant i kimisë | **1** | **24** |
| | Përpunues i metaleve | **1** | **24** |
| **Teknologji ushqimore** | Teknologji ushqimore | **1** | **24** |
| **Tekstil** | Konfeksion | **1** | **24** |
| **Gjithsejt** | | **14** | **336** |

SHMT "Lutfi Musiqi" Vushtrri

| Drejtimi | Profili | | Nr.i paral. | Nr.i nxën. |
|---|---|---|---|---|
| Makineri | Përpunimi i Drurit | Nxënësit me profilin: Përpunimi i Drurit përfitojnë bursë komunale për klasën e 10-të. | 1 | 24 |
| | Operator i Makinave me Dirigjm Kompjuterik | | 1 | 24 |
| | Metalpunues | Nxënësit me profilin: Metalpunues (Saldues) përfitojnë bursë komunale për klasën e 10-të. | 2 | 48 |
| | Instalues i Ngrohjes e Klimatizimit dhe Ujesjellesit e Kanalizimit | | 2 | 48 |
| | Automekanik | | 1 | 24 |
| Elektroteknikë | Teknik i Sistemeve te TI | | 2 | 48 |
| | Teknik i Informatikës së Biznesit | | 2 | 48 |
| | Instalues Elektrik | | 2 | 48 |
| | Mekatronikë | | 1 | 24 |
| | **Gjithsej** | | **14** | **336** |

1. **Kushtet e përgjithshme për regjistrimin e nxënësve të rregullt**
   1.1. Për regjistrimin e nxënësve në klasën e 10-të, në Gjiminaze dhe shkolla profesionale, për vitin shkollor 2020/2021, mund të konkurrojnë kandidatët të cilët e kanë mbaruar arsimin e obligueshëm dhe nuk janë më të vjetër se 17 vjeç.
   1.2. Nxënësit, të cilët e kanë mbaruar klasën e 9-të, jashtë Kosovës, obligohen ta bëjnë njohjen e certfikatave apo dëftesave në MASH, dhe pastaj të konkurrojnë për regjistrim.

2. **Dokumetet e nevojshme për konkurrim**
   2.1. Nxënësit për të konkurruar për regjistrim në klasën e 10-të, në Gjimnaze dhe shkolla profesionale, duhet të paraqesin këto dokumente:
   2.2. Fletëparaqitjen ( e cila merret në shkollën në të cilën konkurron) ;
   2.3. Dëftesen orgjinale për kryerjen e shkollës së mesme të ulët (6-9) dhe
   2.4. Certifikatën e lindjes
   Sqarim: shkolla duhet të krijojë kushte për mbajten e distancës së nxënësve gjatë aplikimit të tyre.

3. **Afati i paraqitjes së dokumeteve dhe shpallja e rezultateve**
   3.1. Paraqitja e dokumeteve për gjimnaze dhe shkolla profesionale për vitin shkollor 2020/2021, bëhet me datën 17-21 gusht 2020, në lokalet e shkollës amë, ku nxënësi dëshiron të regjistrohet duke filluar nga ora 8.00-16.00
   3.2. Publikimi i rezultateve për pranimin e nxënësve:
      3.2.1. 24 gusht 2020 ( në shkollat ku plotësohet numri).
      3.2.2. 28 gusht 2020 ( në shkollat ku nuk plotësohet numri i nxënësve dhe vazhdon konkurrimi).
      3.2.3. Kthimi i dokumeteve për nxënësit, të cilët nuk janë pranuar do të bëhet prej 24-31 gusht 2020.
      3.2.4. Kandidati i refuzuar dhe i cili dyshon se i janë shkelur kriteret e regjistrimit ka të drejtë që brenda 24 orëve, nga koha e shpalljes së rezultateve t'i paraqes ankesë drejtorisë së shkollës, drejtorisë komunale të arsimit dhe në raste të jashtëzakonshme edhe MASH- komisioni për ankesa.

4. **Kriteret për regjistrim**
   4.1. Nxënësi për regjistrim në klasën e 10-të duhet t'i plotësojë këto kritere:
   4.1.1. Nota mesatare e të gjitha lëndëve (klasat 6-9) (60%) 60 pikë
   4.1.2. Nota mesatare nga lëndët prioritare ( klasa 6-9) ( 40%) 40 pikë
   4.1.3. Kriteri i lëndëve prioritare nga suksesi për gjimnaze dhe shkolla të mesme të mjekësisë është që mesatarja e këtyre lëndëve të jetë 4 e me lartë ( Së pari gjendet mesatarja e 4 lëndëve prioritet veç e veç, pastaj mesatarja e mesatareve të atyreve lëndëve).

   4.2. Lëndët prioritare për drejtimet përkatëse:
      **4.2.1. Gjimnazi i shkencave natyore**
      Lënda I – Fizikë
      Lënda II- Kimi
      Lënda III- Biologji
      Lënda IV- Matematikë

**4.2.2. Gjimnazi i shkencave shoqërore dhe gjuhësore**
Lënda I- Gjuhë amtare
Lënda II- Gjuhë angleze
Lënda III- Histori
Lënda IV- Gjeografi

**4.2.3. Shëndetësi, Bujqësi dhe Veterinari**
Lënda I- Fizikë
Lënda II- Kimi
Lënda III- Biologji
Lënda IV- Gjuhë amtare

**4.2.4. Makineri , Elektroteknikë, Gjeodezi, Ndërtimtari, Xehetari, Gjeologji, Grafikë dhe Komunikacion , Kimi- Teknologji**
Lënda I- Fizikë
Lënda II- Kimi
Lënda IV- Matematikë
Lënda V- TIK

**4.2.5. Ekonomi**
Lënda I- Gjuhë amtare
Lënda II- Gjeografi
Lënda III – Matematikë
Lënda V- TIK

5. Kriteret e përgjithshme për llogaritjen e pikëve

5.1. Nxënësi nga sukesesi i përgjithshëm i shkollimit të obligueshëm ( kl. 6-9) mund t'i fitojë maksimalisht 60 pikë. Formula e për llogaritjen e pikëve të suskesit është : ( mes. kl.6+mes.kl.7+ mes. kl.8+ mes kl.9) x 3=60 pikë maksimale.

5.2. Nxënësi nga suksesi në lëndët prioritare, maksimalisht mund t'i fitojë 40 pikë, shuma e mesatares së 4 lëndëve shumëzohen me 2. ( mes. lënda (I) +mes.lënda (II) +mes.lënda ( III) +mes.lënda (IV) x2 = 40 pikë maksimale.

5.3. Në rast se nuk mund të bëhet pranimi ngase kandidatët kanë pikë të barbarta do të mërren parasysh edhe këto kritere shtesë. Suksesi në klasat 1-5 mbildhen nota mesatare e 5 viteve dhe pjestohet me 5 pikë.

5.3.1. Pjesëmarrja në gara ndërkombëtare të diturisë ...............5pikë
5.3.2. Vendi i parë në gara shtetërore të diturisë........................5pikë
5.3.3. Vendi i dytë në gara shtetërore të diturisë........................4 pikë
5.3.4. Vendi i tretë në gara shtetërore të diturisë........................3 pikë
5.3.5. Vendi i parë në gara komunale të diturisë........................3 pikë
5.3.6. Vendi i dytë në gara komunale të diturisë........................2 pikë
5.3.7. Vendi i dytë në gara komunale të diturisë........................1 pikë

5.4.Nëse shkolla edhe me këto kritere shtesë nuk mund të bëj përzgjedhjen e kandidatëve me pikë të barabartë, atëherë shkolla për këta kandidatë organizon vlerësim apo testim.

5.5.Vërejtje: Varësisht prej fluksit të nxënësve , shkollat të formojnë më shumë komisione të pranimit të dokumentacionit si dhe të caktojnë staf mbështetës për të mbikëqyrur respektimin e masave edhe në oborr të shkollës.